

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP), Zyra Rajonale e Prishtinës, në emër dhe për llogari të Ndërmarrjes Shoqërore “[J...]” me seli në Beograd, kundër të paditurës Ndërmarrja për Qarkullimin e Derivateve të Naftës “[K...]” me seli në Prishtinë, me pronar “[B.S]”, duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **25/02/2019**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente në pikëpamje lëndore Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, me aktvendimin e saj, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, me arsyetim se palët ndërgjyqëse janë persona juridik dhe kompetent në pikëpamje lëndore për vendosjen e kësaj çështje juridike është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, të cilës i është dorëzuar lënda për procedim të mëtejshëm.

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike ka ushtruar kërkesë pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me të cilën e ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar se Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, është kompetent në pikëpamje lëndore dhe territoriale për vendosje në këtë çështje juridike.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, për arsye se objekt kontesti nuk janë mos marrëveshjet afariste ndërmjet subjekteve ekonomik, por kemi të bëjmë me kontest kompensimi që buron nga uzurpimi i pronës së paluajtshme e cila gjendet në Zonën kadastrale të Vitisë e sipas nenit 13 të Ligjit për Gjykatat, ligjvënësi ka paraparë: Departamenti për Çështje Ekonomike e Gjykatës Themelore është kompetent për çështjet në vijim: 1.1. kontestet ndërmjet

personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste, ndërsa paragrafi 1.3 i po këtij ligji ka paraparë: kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, ndërmjet palëve të cekura në nën-paragrafi 1.1 të këtij paragrafi. Andaj për procedimin e kësaj çështjes juridike është kompetencë lëndore Gjykata në territorin e të cilës ndodhet prona lidhur me nenin 41 të LPK-së.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 25.1 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.1/19, me datën 25.02.2019

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v